



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:181428

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05630001

KPPP.nr.1719/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës SH.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit Kuvendi Komunal Rahovec, me seli në rr. “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit Përbarimor E.nr.1572/13 të datës 24.01.2014, të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, jashtë seancës, me datën 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Kuvendi Komunal Rahovec, dhe aktvendimi përbarimor E.nr.1572/13 i datës 24.01.2014, i lejuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës SH.A., ka caktuar aktvendimin për përbarim E.nr.1572/13 të datës 24.01.2014, duke lejuar përbarimin në bazë të Historiatit të konsumatorit me Nr. amë 80303012466 me nr. tf: 44502654, me të cilën urdhërohet debitori që në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit t'i paguaj kreditorit shumën prej 545.10 € me kamatë prej 3.5% duke filluar nga data 29.02.2012 e deri në ditën e pagesës si dhe shpenzimet e përbarimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, me marrjen, regjistrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, si dhe

me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë rrjedhëse dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi aktvendimin për përmbarrim, duke theksuar se në bazë të nenit 374 të LMD-së kërkesa e kreditorit është parashkruar në tërësi dhe se propozimi për përmbarrim si dhe vendimi nuk kanë të bëjnë me Komunën e Rahovecit, për shkak se numri i telefonit me të cilin janë krijuar borxhet nuk është pronë e debitorit dhe se me përfundimin e mandatit të kryetarit si bartës i këtij numri janë ndërprerë të gjitha të drejtat dhe detyrimet. Andaj meqenëse në rastin konkret kemi mungesë të provave, parashkrim të lëndës dhe mungesë të legjitimitetit pasit të debitorit, debitori i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ta përfundoj përmbarrimin në tërësi, si dhe të anuloj të gjitha veprimet e kryera duke e obliguar debitorin që t'i kompensojë shpenzimet procedurale, përfshirë edhe përpilimin e prapësimit në shumën prej 101.40 €, si dhe taksat gjyqësore për prapësim.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, lidhur me këtë çështje përmbarrimore me Aktvendimin E.nr.1572/2013 të datës 11.06.2015, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin En.nr.104/15 të datës 10.09.2015 ka pranuar ankesën e debitorit dhe ka prishur aktvendimin E.nr.1572/2013 të datës 11.06.2015 dhe e ka kthyer lëndën në rivendosje dhe rigjykim.

Sipas Aktvendimit E.nr 1572/2013 të datës 09.02.2016, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike është shpallur jo kompetente për të vendosur dhe për të ndërmarr veprime të mëtejshme në këtë çështje përmbarrimore, ndërsa pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, lëndën së bashku me të gjitha shkresat e saj ia ka dërguar Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec.

Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, sipas Aktvendimit E.nr 176/2016 të datës 28.08.2023 është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka dërguar

për vendosje Gjykatës Komerciale të Kosovës në Prishtinë, duke marr numrin e ri KPPP.nr 1719/23.

Gjykata Komerciale, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, vlerësimi të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në dokumentin në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbartim dhe është lejuar përmbartimi, gjeti se i njëjti dokument është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit, e rrjedhimisht propozimi për përmbartim është paraqitur në kundërshtim me nenin 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*

Bazuar në dispozitën e sipërcituar, gjykata gjeti se në rastin konkret aktvendimi përmbartimor E.nr.1572/13 i datës 24.01.2014, është nxjerrë pa plotësimin e kushteve për lejimin e përmbartimit, ngase propozimi për përmbartim bazohet në një dokument kopje dhe si i tillë përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar aktvendimi për përmbartim si dhe ligjshmërinë e këtij aktvendimi përmbartimor.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktvendimit për përbarim, ndërsa organi përbarues - gjykata, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi aktvendimin përbarimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43, nenit 71 dhe nenit 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1719/23, datë 26.04.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.